

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 15, paragrafi (6) dhe neni 29, paragrafi (2) të Ligjit për Mediume ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13 dhe 13/14 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 63/24, 74/24, 218/24 dhe 87/25), pika 7 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr. ark.01-4241/1 të datës 01.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr. ark.03-2196/1 të datës 20.05.2026 dhe Konkluzionin nr. ark. 02-2502/2 të datës 19.06.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 23-të të mbajtur më 19.06.2026, miratoi si vijon:

**Aktvendim
për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) TELEVISIONI PLUS ShPK Kumanovë, për shkak të shkeljes së nenit 15, paragrafi (6) të Ligjit për Mediume (LM), për shkak se transmetuesi drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në afatin e parashikura ligjor deri më 31 mars 2026, nuk ka paraqitur raport me shkrim mbi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv në vitin 2025.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr. ark.03-2196/1, të datës 20.05.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr. 1.

2. URDHËROHET që ShTR TELEVISIONI PLUS ShPK Kumanovë, në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Mediume.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe dita e miratimit konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Mediume (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM-së.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias ndërmerr masë - paralajmërim publik në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV-së dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga leja dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29, paragrafi (2) të Ligjit për Mediume, masat që Agjencia, si organi rregullator kompetent, mund t'i ndërmarrë, dhe që janë përcaktuar në LShMAAV-së, gjithashtu do të zbatohen dhe në rast të shkeljes së dispozitave të Ligjit për Mediume.

Në pajtim me nenin 15, paragrafi (6) të Ligjit për Mediume, transmetuesit janë të detyruar t'i paraqesin raport me shkrim organit rregullator kompetent mbi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv dhe radio, dhe në veçanti për zbatimin e konceptit programor, jo më vonë se 31 mars të vitit aktual. Si shtojcë e raportit dorëzohet dhe informacion mbi mjetet teknike përmes të

cilave transmetohet ose ritransmetohet shërbimi i tyre programor në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë saj. Raporti me shkrim dorëzohet në formularin e përcaktuar nga organi rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 19 maj 2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi ShTR TELEVISIONI PLUS ShPK Kumanovë, gjatë së cilës konstatua shkelja e nenit 15, paragrafi (6) të Ligjit për Mediume.

Nga mbikëqyrja e rregullt u konstatua se ShTR TELEVISIONI PLUS ShPK Kumanovë, në afatin e parashikuar ligjor (31 mars 2026), nuk i ka dorëzuar Agjencisë raportin me shkrim mbi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv, veçanërisht mbi zbatimin e konceptit programor, as informacion mbi mjetet teknike përmes të cilave transmetohet ose ritransmetohet shërbimi programor në vend ose jashtë vendit, duke mos i përmbushur kështu detyrimet sipas nenit 15, paragrafi (6) të Ligjit për Mediume.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.03-2196/1, të datës 20.05.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojca nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë drejtua ShTR TELEVISIONIT ShPK Kumanovë më 21.05.2026, i dërgoi Shkresë nr.ark. 03-2196/2 të datës 21.05.2026, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.03-2196/1 të datës 20.05.2026, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklaratën me shkrim në lidhje me shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 27.05.2026. Në afatin e parashikuar, ShTR TELEVISIONI PLUS ShPK Kumanovë, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të Ligjit. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 19.06.2026, pasi shqyrtoi Raportin me shkrim arriti në përfundimin se ndaj ShTR TELEVISIONI PLUS ShPK Kumanovë të shqiptohet masë - paralajmërim publik .

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, dhe në lidhje me nenin 15, paragrafi (6) dhe neni 29, paragrafi (2) të Ligjit për Mediume, pika 7 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës dhe Raportit me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.03-2196/1 të datës 20.05.2026, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për Mediume, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimit, Këshilli i Agjencisë në seancën e 23-të të mbajtur më 19.06.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-2502/2 të datës 19.06.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron ShTR TELEVISIONI PLUS ShPK Kumanovë, dhe urdhëron që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Mediume. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV-së, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi, botuesi i medias (transmetuesi) ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.